

MIMOZA ZEKAJ

**ROLI I PËRSËRITJES NË ORGANIZIMIN GJUHËSOR E STILISTIK
NË VEPRËN E MUSINE KOKALARIT**

Gjuha e veprave të Musine Kokalarit është një gjuhë e thjeshtë, pa ngarkesa e ndërlikime, gjuhë e kuptueshme e bisedave të përditshme, që ngjan si e regjistruar nga subjekte konkrete. Autorja është bartëse dhe njohëse e shkëlqyer e kësaj idiome, prandaj dhe ka ditur ta përdorë atë bukur në veprë. Personazhet e saj ngjajnë mjaft të natyrshëm, prandaj dhe gjuha e tyre është natyrore. Zgjedhja e gjuhës natyrore nga shkrimtarët dhe jo e standardit që është një gjuhë e krijuar, është një hap i guximshëm, sepse kërkon njohje të plotë të gjuhës dhe aftësi për ta shprehur atë¹.

Një dukuri gjuhësore që i përshtatet mjaft mirë kësaj gjuhe është përsëritja, të cilën autorja e ka përdorur në vargun e atyre mjeteve që i japin gjallëri gjuhës së folur. Me këtë vlerë gjejmë të përdorur më shumë përsëritjet foljore, ndajfoljore, disa përsëritje mbiemërore, disa emërore, përsëritje të fjalëve onomatopeike dhe pasthirmave. Përsëritja gjuhësore në veprën e Musinesë është e shumëllojshme. Në punimin tonë kemi bërë objekt vlerën e saj në organizimin gjuhësor, si figurë ndërtimi dhe si përftesë shprehëse, pra, do të trajtojmë vlerën e këtij mjeti gramatikor, leksikor e stilistik në veprën e kësaj autoreje. Edhe autorja jonë, si shumë autorë të tjerë, të cilët kanë qenë njohës të kësaj idiome, e kanë përdorur përsëritjen me shumë funksione. E ka përdorur për të theksuar e për të dalluar diçka të veçantë, për të veçuar e sforcuar një element të rëndësishëm, për të kundërvënë e për të bashkuar shumëçka në rrafshin logjik, kuptimor, gjuhësor e artistik, për të arritur efekte të veçanta stilistike, në pamje lirike, në ngjarje dramatike, në përshkrime e situata të ndryshme ligjërimore².

Përsëritja e plotë ose e pjesshme e një rrënje, e një teme a e një fjale, duke mos u ndryshuar ose duke u ndryshuar pjesërisht përbërja e tyre fonetike, shërben si mjet gramatikor në shumë gjuhë indoevropiane e sidomos joindoevropiane. Në gjuhët indoevropiane hasen vetëm përsëritje fjalësh të plota, kryesisht me vlerë stilistike, por që ngandonjëherë shprehin edhe këtë ose atë kuptim gramatikor. Në këto raste kemi të bëjmë me togfjalësha dhe përsëritja këtu duhet parë si një mjet gramatikor analitik që përdoret krahas mjeteve të tjera gramatikore e leksikore të gjuhës³.

¹ Th. Dhima, *Veçori sintaksore në veprën e M. Kokalarit*, kumtesë në Konferencën Shkencore Kombëtare “Jeta dhe vepra e M. Kokalarit”, organizuar nga Universiteti i Gjirokastrës, 10 dhjetor 2009.

² Sh. Islamaj, *Gjuha e Jakov Xoxës*, Prishtinë, 2000, f. 258.

³ E. Lafe, *Përsëritja si mjet gramatikor*, në SF, 4, 1966, f. 120.

Vlera dhe roli sintaksor i përsëritjes janë trajtuar në studime të ndryshme dhe në Gramatika të ndryshme. Gramatikat kanë shënuar disa raste të përsëritjes, si p.sh. përsëritjen e një emri, të një numërori a të një ndajfoljeje, kur formohet një lokucion ndajfoljor, përsëritjen e foljes në të pakryerën e në të kryerën e thjeshtë të dëftores dhe në urdhëroren, kur shërben për të shprehur aspektin e vazhdimësisë etj.

Duke kundruar veprën e M. Kokalarit, vëmë re përsëritje të njëjësive të ndryshme leksikore, përsëritje të njëjësive morfologjike apo edhe të varianteve morfologjike, të konstruktëve sintaksore. Këto përsëritje përdoren të kombinuara e të ndërkryera brenda një fjalie dhe mikroteksti, të cilat shpesh herë u japin ngjyrimë të ndryshme kuptimore gjymtyrëve të fjalisë, denduri apo informacion plotësues.

Përsëritjet foljore. Janë përdorur më shumë me vlerë aspektive. Në gjuhët e familjes i.e., kundërvëniet kohore ndërthuren edhe me dallime aspektore. Në ato gjuhë që nuk e kanë aspektin si kategori të veçantë, disa vlera aspektore shprehen me mjete leksikore⁴. Aspekti në gjuhën shqipe nuk është një kategori thjesht gramatikore si p.sh. në gjuhët sllave. Ai ka të bëjë kryesisht me kuptimin leksikor të foljes si p.sh. në frëngjishten, por, duke qenë se shqipja ka edhe disa forma të posaçme gramatikore me këtë vlerë thjesht aspektive, mund të themi se aspekti në këtë gjuhë është një kategori leksiko-gramatikore. Për të shprehur aspektin e vazhdimit e të zgjatjes së veprimit në kohën e tashme e në të pakryerën, shqipja përdor një formë gramatikore analitike të ndërtuar nga e tashmja, respektivisht e pakryera ose e kryera e thjeshtë e foljes *jam + përcjelloren e foljes* që zgjedhim. Veç këtyre trajtave që janë të shpeshta dhe në gjuhën letrare, nëpër dialekte gjenden edhe trajta të tjera me vlera të ndryshme aspektive. Një nga mjetet më të preferuara të gjuhës popullore për shprehjen e aspektit është edhe përsëritja⁵.

Konstruktet më të përdorshme në vepër janë përsëritjet asidentike, pra midis dy foljeve pa lidhëz a fjalë lidhëse dhe përsëritjet midis dy foljeve, por me lidhëz a fjalë lidhëse në mes tyre. Pavarësisht mënyrës së ndërtimit të tyre, këto konstruktë janë përdorur për të shprehur aspektin e vazhdimit a të rritjes intensive të veprimit. Folja që përsëritet mund të jetë në mënyrën dëftore, në urdhëroren ose në përcjellore. Kur është në mënyrën dëftore, folja ka zakonisht trajtën e së pakryerës ose të së kryerës së thjeshtë dhe në më të shumtën e rasteve përsëritet nëpërmjet lidhëzës këpujore *e: E fualmë e fualmë, moj Aishe, sa plasmë, sa të laçë dhe ti pa punë* (Ësh., f. 31); *Shiu dha e dha bëri atë të tijnë dhe më në funt pushoi* (E gj., f. 9); *I fërkoj e i fërkoj me hi sa i ranë gjishtëret, qenë bërë tenxheretë, si mos o zot* (S'ja., f. 16); *Priti e priti, pa se u zgjat puna* (D., f. 30); *Në funt i shturi një çikë kripë dhe ngjeshi brumët. Jep e jep me grushte* (Ja., f. 68); *Ec e ec, ca mbenë prapa dhe ca u-kthien në shtëpi* (Na., f. 103); *Kur janë zunë të gjithë, njëri pas tjetrit, fiu e fiu, fiu e fiu, kapërce e kapërce zjarrin* (Na., f. 111); *Ajo mendohesh e mendohesh dhe më në fund tha, këtë punë...* (Un., f. 34); *Ç'e mbaje teto Xhemon, i*

⁴ R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 243.

⁵ E. Lafe, *artikull i cituar*, f. 122.

Roli i përsëritjes në organizimin gjuhësor e stilistik në veprën ...

u-fri hunda, o të keqen, i drodhi e përdrodhi buzët, hangri vehten me dhëmbë...(Di., f. 42) etj.

Një zgjatje më e madhe e veprimit të kryer nga folja realizohet me rimarrjen e saj disa herë, si: **E gëzoftë, e gëzoftë u përgjegj teto Haxhua** (U, u., f. 27); **Urdhëro, udhëro brënda, zotrote je e shtëpisë, urdhëro këtu, ku rimë vetë, ne jemi t'onat** (Nj., f. 57). **E pashë e pashë, nuk dua të më thuash një qind herë.** (Si., f. 100). **Ajo bëri sikur s'dëgjoiti "ulu, ulu" i tha prapë teto Ruhua** (Me., f. 259). Te rasti i përsëritjes së lidhore, vlera durative nuk mungon, por, sidoqoftë nuk është kryesorja. Kryesorja është theksimi i kuptimit që shpreh folja, pra intensiteti⁶, si: **Të pëlcaç, të pëlcaç, Nana foli Shuqurit** (Ni., f. 51); **T'i numërosh, t'i numërosh të gjitha që janë në...Të raftë, të raftë..** (U. f. 27).

Përsëritjet e tipit *folje + sa + folje* janë përdorur në vepër, ashtu si në të folurit e përditshëm: **Ndënjën së ndënjën, pastaj u ngritën** (Da., f. 20); **Rin sa rin dhe i ndreqte nga një çikë festen me florinj** (Di., f. 164) etj. Kuptimi i këtij togu është që të shprehi një farë kufizimi të veprimit; e ky kufizim bëhet në planin e volumit të shtjellimit të veprimit, në shkallën e intensitetit të shfaqjes së tij, si dhe në planin kohor⁷.

Në të gjitha konstruktet foljore një element i rëndësishëm që merr pjesë në realizimin e shprehjes së vlerave të ndryshme aspektive të përsëritjes është intonacioni. Sipas prof. M. Çelikut, përtaqësia e takon anës strukturore duhet thanë që intonacioni në disa toge foljore asht faktori kryesor, në mos qoftë i vetmi që i jep konstruktit të dhënë këtë apo atë kuptim, d.m.th. përfaqëson tiparin e vetëm esencial për diferencimin kuptimor të konstrukteve⁸.

Përsëritjet ndajfoljore. Në vepër ka mjaft lokucione ndajfoljore, të cilat, nga pikëpamja strukturore, janë të ndryshme. Shërbejnë për intensifikimin e kuptimit të përgjithshëm ose për të treguar një rritje progresive të cilësisë së një veprimi ose të një rrethane vendore. Sipas prof. E. Lafe, përsëritja në fjalë e ndajfoljeve të shqipes e të rumanishtes të kujton përsëritjen e po kësaj pjese të ligjëratës në turqishten jo vetëm në pikëpamje të formës, por edhe nga vlera. Ajo shërben për intensifikimin e kuptimit të përgjithshëm. Po këtë vlerë kanë në gjuhën shqipe edhe përsëritjet *ndajfoljeve + e + ndajfolje* që hasen më shpesh se përsëritjet *ndajfolje + ndajfolje*, si: *fët e fët, shpejt e shpejt* etj.⁹ **Po xhang xhing udhët** (Pë., f. 58); **Vate prapa e prapa** bashtesë së Teqesë, gjeti nipin me lakra në duar (S'j., f. 16); **Pastaj dhe ç'e hiqje gjith' atë udhë troiro e troiro; atyre u vuri drunë dhe tani ngruhuni se me një ju zë gjumi. Shpejt...shpejt** (E., f. 15); **Burërija kolle, kolle dilte pazarit** (S'j., f. 12); **Jashtë jashtë ...uluriti mbreti, kjo s'di të hajë..** (Si., f. 105); **është këshu, këshu puna** (Ë., f. 26); **i vinin përpara sive ëndërat e natës së**

⁶ E. Lafe, *artikull i cituar*, f. 126.

⁷ M. Çeliku, *Disa toge foljore në shqipen e sotme*, në BUSH, SSHSH, I, Tiranë, 1963, f. 172.

⁸ M. Çeliku, *Disa toge foljore në shqipen e sotme*, në BUSH, SSHSH, I, Tiranë, 1963, f. 161.

⁹ E. Lafe, *artikull i cituar*, f. 135.

shkuar, gjëpora e gjëpora (Da., f. 18); *Kish ditë që koha që bërë pambuqe pambuqe* (Pë., f. 58); *Për një qint petë njëzet ve. Fët e fët i çajti; E zuri kjo me gjithë fuqi sa kish. Frap e frap e ngjeshi sa u-bë si flugë* (Ja., f. 68); *Fët, fët moj Nesli, unë kaqë di, kaqë të thom se njeri nuk mbaj vesh* (Mo., f. 69); *Ngëcë, ngëcë kali, u-largua dalë nga dalë, dhe sa hiri prapa kodrës dielli maleve ra* (U., f. 46); *Nënua e ndau pjesë pjesë* (U., f. 26) etj.

Me lokucionet ndajfoljore lidhen për nga origjina edhe njësitë e formuara nga përsëritja e drejtpërdrejtë e një emri në formën e numrit shumë. Përsëritjet e këtij tipi, me shkrimin si një fjalë me vizë lidhëse, kanë marrë tipare fjalësh të përbëra. Nga ana kuptimore përsëritjet e këtij tipi tregojnë kryesisht mënyrën e kryerjes së një veprimi, më rrallë tregojnë rrethana kohe dhe vendi¹⁰. *Po vë gjërat kallëp-kallëp* (E., f. 5); *Dbora binte flokë-flokë e me ngadalë* (Va., f. 50); *Vërtet Xhemua s'kish të sharë, po siri është damarë-damarë; në krie ja kish bërë fruda-fruda dhe përpara me një fletë* (Sa., f. 45); *Teto Hatixheja e preu kulaçin copa-copa dhe e ndau në të gjitha që ndërnin dorën e kush të mirte më parë* (Di., f. 183); *Malet e Lunxhërisë, vënde-vënde të larta, vënde-vënde më të ulta, zbardhonin* (S., f. 10); *Ai burrë q'ë donte atë Mukades aqë shumë, që ja bënte qejfet lloi-lloi, q'ë shpuri nga të katër anët e botës, kur që e sëmure, gjë s'i la pa bërë* (Bu., f. 22); *E pse babaj, që bukën nga gola ja ka marrë fshatarit, pa le kur vinin agojatet i binin barë-barë thesët me gurë...* (Pë., f. 15) etj.

Në vepër bien në sy edhe lokucione ndajfoljore të formuara nga përsëritja e të njëjtit emër me ndërmjetësinë e parafjalëve të ndryshme: *Mëngjes për mëngjes lante, lante tatëpjetëlat* (Sa., f. 44). Në përsëritjet e këtij tipi ka mjaft raste që, në kontekste të ndryshme, i njëjti lokucion mund të tregojë herë vendin, herë mënyrën e kryerjes së një veprimi. Më rrallë në vepër disa lokucione të tilla janë përdorur për të treguar kohën e kryerjes së një veprimi të përsëritur, si: *Mëngjes për mëngjes lante tatëpjetëlat*. Më shpesh përdoren për të treguar vendin e kryerjes së veprimit. *Shakara janë këto, vetëm mua të më kishin pjetur që jam e brëndëshme, e hirë dhe e dalë, këtu, portë më portë, pa dija se ç'thoshnja* (U., f. 25); *I zuri gjë fruthi, se hiqet shtëpi më shtëpi?* (Nj., f. 58). Në disa raste përdoren për të treguar mënyrën e kryerjes së veprimit: *Me punë në dorë e kokë më kokë flitnin me njera-jetrën dhe nuk dëgjonin se shkonte njeri udhës* (E., f. 8). *Krushkat muarnë udhën kokë më kokë e pëshë- pëshë me njera-jetrën* (Di., f. 90). Më të rralla në vepër janë lokucionet ndajfoljore të formuara nga përsëritja e një emri me ndërmjetësinë e parafjalës me dhe *mbi*, të cilët tregojnë mënyrë ose vend. *Zotrote je zverdhur e je bërë dillë, besoj se nuk keni mbillur kapak me kapak* (Ud., f. 38); *U nise ku do veç, o pullumb, more pullumb, atje lark e në gurbet, moj thëllëza gur mbi gur* (Ud., f. 40).

Me tipin e mësipërm lidhen dhe njësitë e formuara nga përsëritjet në trajta të ndryshme të tipit *emër në emëroren e shquar njëjës + emër në dhanore të shquar*. Edhe përsëritjet e këtij tipi kanë marrë tipare fjalësh të përbëra¹¹. *Teto Haxhvia dhe*

¹⁰ Gramatika e gjuhës shqipe, nr. 1, Tiranë, 2002, f. 378.

¹¹ Po aty, f. 378.

Roli i përsëritjes në organizimin gjuhësor e stilistik në veprën ...

teto Qibrua, *ffjala-ffjalës thanë si do ta bënë punën* (E., f. 9); *E kështu ffjala-ffjalës erdhi darka* (Sa., f. 49).

Me vlerë ndajfoljore janë përdorur edhe përsëritjet e formuara nga rimarrja e të njëjtit emër pa ndërmjetësinë e ndonjë mjeti lidhëz, si: *Vapa, vapë dhe mbi të gjitha u duadhnë dhe tahtabiqet* (Da., f. 23); *I vinin përpara sive ëndërat e natës së shkuar. E ku vete moj Hano kështu mëngjes mëngjes?* (Da., f. 19).

Interes në vepër paraqesin përsëritjet e **emrave** dhe të **pjesëve të tjera të ligjëratës**, duke fituar kuptime të ndryshme. Përsëritja e një fjale apo shprehjeje leksikore, ka vlerë jo vetëm për kuptimet që marrin përsëritjet, por edhe për strukturën e fjalisë ku janë përdorur. *Oh, kohë, kohë e shkretë, se si u kthie kjo botë përmbis* (Si., f. 3); *...s'bie poshtë, vajz' e nënës e heth vickën vickë* (Bu., f. 21); *E ç'ethe, ç'ethe zeza i thaçë, është kështu, kështu puna* (Ë., f. 26); *Ç'djalë, ç'djalë e pastaj fat që pati gomarja!* (Ë., f. 32); *U-ngrenë vajzat e vajzat në mes të odasë. O pullumb, more pullumb* (Ud., f. 40); *Eh! Pleqëri, pleqëri e zezë, thoshte me vehte* (Ul., f. 74); *Në avli, në avli thoshte ajo, ta shohin të gjithë* (Di., f. 164); *Dhëlpëra, dhëlpëra, përtej në arë* (Na., f. 205); *Qenë shumë apo të sajtë e të sajtë?* (Ud., f. 38); *Tek djali i Sefer efendiut..dizet bushtra dhe dizet fatpadala brënda* (E., f. 7); *Gratë e mëhalesë iknë dhe të turret e turret u-futnë brënda* (Di., f. 91); *Hop një herë Ibrahim i dhe një..një.. një...., halla, halla ulurin të gjitha, di..di., tre..tre* (Na., f. 111); *Me hakë me hakë u-përgjegj Teto Qibrua* (R., f. 59) etj. Konteksti gjuhësor i përdorimit të përsëritjeve dhe gjithë përmbajtja e veprës, shpalosin efektin që ato ngjallin, rolin që luajnë në diferencimin e situatave ligjërimore dhe në rritjen e nivelit të shprehësisë leksikore.

Për të shprehur një shkallë të lartë të cilësisë, në gjuhën popullore dhe letrare, përveç shkallës sipërore të mbiemrit përkatës, përdoren edhe disa emra me kuptim të fyturuar, të cilët në rastin e dhënë nuk emërtojnë më sende, por një nga tiparet më karakteristike të këtyre sendeve, të cilën ata e kanë në një shkallë shumë të lartë¹². **Përsëritja**, si mjet për të shprehur **shkallën sipërore absolute të mbiemrit**, gjendet më fort e përdorur në ligjërimin e përditshëm sesa në letërsinë artistike. Kjo mënyrë e tillë veç vlerës gramatikore, ka edhe një vlerë afektive të fortë që mungon te sipërorja absolute e formuar me ndajfoljen *shumë*¹³. Rolin e përsëritjes për të shprehur shkallën sipërore absolute të mbiemrit në gjuhën shqipe, e ka përmendur edhe studiuesi K. Cipo në gramatikën e tij. Ai nënvizon se "*Herë-herë, kur duam që cilësia të paraqitet në një shkallë shumë të lartë, përdorim disa krahasime të shkurtëra për t'i dhënë ligjëratës një farë shkëlqimi: burr' i burrave; djalë për kokën e djalit*¹⁴". Në veprën e M. Kokalarit kemi gjetur disa raste të përsëritjes së emrave në funksion të shprehjes së shkallës sipërore të mbiemrit. Kemi hasur edhe disa konstrukte po me të njëjtin vlerë, por që janë pjesë e ligjërimin të përditshëm të popullit. *Është djalë për kokën e djalit, që nuk e ka shoknë* (Di., f. 175); *Haxhua e pa mir' e mirë odanë. Llams e feks dishemetë*

¹² Gramatika e gjuhës shqipe, I, Tiranë, 2002, f. 179.

¹³ E. Lafe, artikull i cituar, f. 131.

¹⁴ K. Cipo, Sintaksa, Tiranë, 1952, f. 25.

vetëtinin...për t'i lëpirë me gjuhë (S., f. 13); *Është një vajzë, për kokë të vajzës, njeri s'e ka* (S., f. 14) etj.

Në veprën e M. Kokalarit përsëritja është e shpeshtë dhe e përdorur në nivele të ndryshme. Më së shumti përsëritet në ligjërimin e shkrintares, në karakterizimet e personazheve, në përshkrimet e mjediseve dhe dhënien e natyrës. Shfaqet mjaft dukshëm te fjalët **onomatopeike dhe pasthirrmat**, të cilat sjellin në vepër zhurmat e ndryshme të sendeve dhe të objekteve. Në këtë aspekt vepra e saj është mjaft e pasur. Bota që autorja ka dashur të projektojë nëpërmjet veprës së saj, shfaqet me të gjithë tingujt, ngjyrat, zhurmat, britmat e gjallesave, sendeve, dukurive të ndryshme të natyrës, sidomos të vetë njeriut që është në qendër të të gjitha zhvillimeve. Kjo është harmonizuar mjaft bukur dhe është gjithmonë në funksion të idesë e të përmbajtjes së veprës, duke krijuar një sfond që i jep ritëm e gjallëri gjithçkaje dhe nga pikëpamja sintaksore, krijon situata të veçanta. *He...he ç'zakone që kishim, si dëgjohej fjala të madhit, si dridheshim, po të paktën kishite hije* (S., f. 5); *Ç'janë ato të hira e të dala, fërc te njëra fërc te tjetra, ato të qeshura, ato të kukurisura* (S., f. 6); *Oh, oh, t'u thafçin ato duar gjer në rëzë, oh, oh, kadalë se m'i nduke që të rëntë të rëndë* (P., f. 16); *Kër...kër bënin drutë që digjeshin dhe nipërit e mbesa pritnin me gojë hapët që të dëgjonin prrallën* (Rr., f. 6); *Trakër-trukër bënin këmbët e kalit. Ata i zuri gjumi me një herë dhe nënua plakë trupur-trupur nëpër shkalla e erdhi poshtë* (Sh., f. 15) etj. Këto përsëritje i bëjnë tekstet ku janë përdorur të marrin një cilësi. Në gjuhën e folur përsëritja është mjet i rëndësishëm intensifikimi ose për të përçuar emocion¹⁵.

Këto pjesë ligjërata shfaqen jo vetëm të përsëritura, por edhe të papërsëritura dhe gjithçka ngjan me një orkestër simfonike të sinkronizuar bukur. Ja si përshkruhet një peizazh dimri që karakterizohet nga zhurma e natyrës: *Vanë sipër në odë dhe nuse-madhe vuri në gjumë dhe u ndënji pranë gjer sa fjetën. E jashtë era frynte me të madhe. Fësh...fësh..binin degët e pemëve e kraf kërcitnin vetëtimat e bu...bu gjëmonin bubullimat. E pikat e shiut tak...tak... goditnin nëpër xhama e mbi çatira* (Va., f. 51) etj. Përshkrimet dalin shumë shprehëse nga përdorimi i përsëritjeve. Në sajë të mjeshtërisë së autores, shpesh përsëritjet, sidomos në këto funksione, marrin motivim artistik.

Duke kundruar veprën e Kokalarit, vëmë re se përsëritja nuk është vetëm përsëritje, por ajo i shërben pasurimit të ligjërimin dhe dëshmon përpjekjet e autores për të realizuar një organizim të pasur ligjërimor. Edhe përsëritja e strukturave sintaksore i jep gjuhës së veprës një përmbajtje të pasur ligjërimore. Çdo element i gjuhës sjell shprehësi, po të rimerret me këtë përftesë, sidomos po të bëhet përsëritja sipas një kriteri organizimi¹⁶.

Në veprën e saj gjen fakte që dëshmojnë për një strukturë të pasur dhe një pasuri të madhe e të larmishme të mjeteve të shprehjes. Larmia e madhe e formave të përsëritjes të përdorura në veprën e M. Kokalarit, nga njëra anë dëshmon mjeshtërinë e madhe të autores, nga ana tjetër dëshmon për njohjen e thellë të

¹⁵ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2006, f. 48.

¹⁶ Xh. Lloshi, *po aty*, f. 48.

Roli i përsëritjes në organizimin gjuhësor e stilistik në veprën ...

gjuhës së popullit nga autorja, të asaj gjuhe që quhet gjuhë natyrore në raport me gjuhën artificiale. Ajo ka ditur ta përpunojë këtë gjuhë, duke na shfaqur pasurinë e madhe të toskërishtes dhe të së folmes së Gjirokastrës në veçanti.

BIBLIOGRAFI

- E. Lafe, *Përsëritja si mjet gramatikor*, në “Studime filologjike”, 4, 1966.
Gramatika e gjuhës shqipe, I, Tiranë, 2002.
Gramatika e gjuhës shqipe, II, Tiranë, 2002.
K. Cipoja, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949.
K. Cipoja, *Sintaksa*, Tiranë, 1952.
M. Çeliku, *Disa togje foljore në shqipen e sotme*, në BUSH, SSHSH, I, Tiranë, 1963.
R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002.
Sh. Islamaj, *Gjuha e Jakov Xoxës*, Prishtinë, 2000.
Th. Dhima, *Çështje të sintaksës së gjuhës shqipe*, Tiranë, 2013.
Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2006.

VEPRAT E VJELA

- M. Kokalari, *Siç më thotë nënua plakë*, Tiranë, 1939.
M. Kokalari, *Sa u tunt jeta*, Tiranë, 1944.
M. Kokalari, *Reth vatrës*, Tiranë, 1944.

